REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR DATË 26.07.2022

Me datë 26.07.2022, u mbajt mbledhja e këshillit bashkiak Shkodër.Këshilltarë të pranishëm ishin: Brisela Kadija, Bledianë Nika, Nersada Mandija, Ermina Gruda, Tereze Brigja, Jona Leqejza, Sabahete Lishi, Vjollca Petani, Danjela Jakoja, Dhurata Tyli, Sabina Danaj,Kristi Agnes Shllaku, Valbona Doniku, Lumnije Guri, Arvit Osja, Gezim Galiqi, Erion Metushi, Luan Heta, Elson Celiku, Oltion Luli,Julian Kraja, Hilmi Lakti, Avenir Celaj, Sead Cocja, Gerald Hasaj, Sokol Zaimaj, Lulash Nika, Hekuran Gjorreta, Besmir Vukaj, Blerim Dimnaku, Gjergj Sokoli , Andi Hallunaj, Luigj Palushi, Nadir Spahija.

Mbledhja hapet nga Kryetarja e Këshillit, znj. Brisela Kadija.

Rendi i ditës së mbledhjes është si vijon:

1. Pr/Vendim: *"Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike deri në 6% për muajin Maj 2022".*

2. Pr/Vendim: *"Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike deri në 6% për muajin Qershor 2022".*

3. Pr/Vendim: *"Për pjesmarrjen e Bashkisë Shkodër në subjekte me kompotenca të përbashkëta me qëllim kryerjen e furnizimit me ujë të pijshëm,grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujrave të ndotura".*

4. Pr/Vendim: *"Për një ndryshim në VKB nr.22 datë 18.04.2019"Për miratimin e planit lokal për veprimin e zhurmës në mjedis,të Bashkisë Shkodër"*

5. Pr/Vendim: *"Për një ndryshim në VKB nr.3 datë 05.01.2022"Për miratimin e buxhetit të vitit 2022 dhe progamit buxhetor aftmesëm përfundimtar 2022-2024 të Bashkisë Shkodër".*

6. Pr/Vendim: *"Për shtesë në buxhetin e vitit 2022, e miratuar me VKB nr.3 datë 05.01.2022 dhe dhe progamit buxhetor aftmesëm përfundimtar 2022-2024 të Bashkisë Shkodër".*

7. Pr/Vendim: *"Për një ndryshim në VKB nr.19,datë 10.05.2022 "Për miratimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur ose të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të Bashkisë Shkodër dhe institucioneve të varësisë".*

8. Pr/Vendim: *"Për miratimin e projektit të parë programit buxhetor afatmesëm 2023-2025 për Bashkinë Shkodër".*

9. Pr/Vendim: *"Për miratimin e rregullores për marrëdhëniet e këshillit bashkiak me publikun dhe median".*

10. Diskutime jashtë rendit të ditës.

Kourumi i domosdoshëm është i pranishëm në sallë, para se të vijohet me hedhjen në votim të rendit të ditës, Kryetarja e këshillit sqaron se rendit të ditës i shtohen edhe dy propozime:

1. Pr/Vendim: *"Për miratimin e sistemeve të pikëzimit për programet e strehimit social".*

2. Pr/Vendim: *"Për miratimin e vjeljes, mbledhjes, grumbullimit dhe shitjes me procedurë ankandi publik të prodhimeve të dyta pyjore të bohceve të pishës,rrënjëve të shqopës, bimëve mjekësore eterovajore dhe tanifere natyrore (MET) për vitin 2022".*

Si dhe propozimi për heqje nga rendi i ditës së pikës 8. Në mbledhjen e datës 31.03.2022 janë hedhur poshtë dy Pr/Vendime me arsyetimin sepse ka qenë vizioni i kryetares në ikje të Bashkisë së Shkodrës dhe kemi pritur të shohim një vizion të ri të kryetarit aktual. Prandaj Znj.Truma propozon që t'i shqyrtojnë në mbledhjet e ardhshme të këshillit, meqënëse këto 2 pika paraprijnë pikën 8 të rendit të ditës.

Kalohet në votimin e rendit të ditës, së bashku me propozimet për ndryshim, ku rezultojnë 34 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

Miratohet

1.Mbledhja vijon me Pr/Vendimin *"Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike deri në 6% për muajin Maj 2022"* dhe me Pr/Vendim: *"Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike deri në 6% për muajin Qershor 2022".*

N/Kryetari i Bashkisë merr fjalën dhe relaton për të dyja pikat e rendit të ditës sipas materialit të përgatitur nga punonjësit e administratës. Kryetarët e grupeve shprehen dakort. Projekt akti i parë hidhet në votim, ku rezultojnë 35 vota Pro, 0 Kundër, 1 Abstenim.
Miratohet

2.Edhe Projekt akti i dytë hidhet në votim, ku rezultojnë 35 vota Pro, 0 Kundër, 1 Abstenim.
Miratohet

3.Vijohet me pikën 3. të rendit të ditës: *"Për pjesmarrjen e Bashkisë Shkodër në subjekte me kompotenca të përbashkëta me qëllim kryerjen e furnizimit me ujë të pijshëm,grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujrave të ndotura".*

Relaton **Znj.Muriqi** sipas materialit të përgatitur.

Fjalën e merr kryetari i bashkisë **Z.Bardh Spahia**, i cili sqaron se në lidhje me sa u tha dhe pretendohet, Këshilli bashkiak nuk ka kompetenca të tilla pasi është në shkelje të përcaktimeve ligjore të parashikuara në ligjin 139 të vitit 2015 për qeverisjen vendore dhe konkretisht në nenin 135 të ligjit 9901 datë: 14.04.2008 për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.

Ai thekson se tagrin për cdo ndryshim të mundshëm e ka vetëm asambleja e përgjithshme e cila merr vendime për cështje që kanë lidhje me këtë shoqëri. Në këtë kontekst ai kërkon rishikimin e një iniciative të tillë. Gjithashtu në bazë të ligjit 139 të vitit 2015 të qeverisjes vendore, kryetari i bashkisë është edhe kryetari i kësaj asambleje.

Z.Galiqi kërkon të dijë argumentet juridike të kësaj mospërputhjeje të iniciativës së tyre me asaj c'ka tha Kryetari.

Z.Vukaj shprehet se Pr/vendimi u relatua dhe propozua në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave. Në materialin e koleges Muriqi u citua edhe baza ligjore. Për me tepër grupi i këshillëtarëve që ka përgatitur propozimin mund të flasë më detajisht.

Fjalën e merr **Znj.Leqejza**,e cila shprehet se nuk është e fushës por para dy vitesh është diskutuar në këshill rasti i Sk.Vllaznisë dhe nuk kuptojn pse sot pretendohet dicka ndryshe.

Z.Mandija merr fjalën dhe në emër të grupit Socialist mbështet iniciativën dhe shprehet pro propozimit. Edhe Z.Spahija shprehet pro në emër të grupit të PSD-së.

Projekt akti hidhet në votim, ku rezultojnë 32 vota Pro, 0 Kundër, 2 Abstenim.
Miratohet

4.Vijohet me pikën 4. të rendit të ditës: : *"Për një ndryshim në VKB nr.22 datë 18.04.2019"Për miratimin e planit lokal për veprimin e zhurmës në mjedis,të Bashkisë Shkodër"*

Fjala për **Znj.Nika** e cila relaton duke iu referuar dhe cituar planin lokal për zhurmat në mjedis të vitit 2019 hartuar nga drejtoria e Mjedisit. Grupi i punës,shprehet ajo nuk i është referuar asnjëherë nevojave reale që ka Nj.Adm.Velipojë duke pasur parasysh impaktin në ekonominë dhe turizmin e kësaj zone. Ajo sygjeron që matjet të kryhen në pikun e pupullimit dhe të sezonit, duke u konsultuar gjithmonë me grupet e interesit. Ajo gjithashtu kërkon të dijë sa i mirëorganizuar dhe sa real është ky plan? Dhe a ekziston një rregullore për stacionet e plazhit, e cila duhet parë dhe miratuar nga Këshilli bashkiak.

Është fakt, shprehet ajo që është kryer një pyetësor përsa i përket zhurmave, por sa janë realizuar këto kërkesa nga ana e bashkisë. Edhe veprimtaria ndërtimore është shumë shqetësuese gjatë sezonit turistik. Për më tepër Bashkia Shkodër duhet të relatojë sa janë realizuar masat e marra dhe pritshmëritë e saja në aktivitete të ndryshme të zhvilluara në Nj.Adm.Velipojë.
Në parim ajo shprehet dakort,por ka disa rezerva për punën në të ardhmen.

Kalohet në mendimet e Kryetarëve të grupeve: **Znj.Mandija** dhe **Z.Sokoli** shprehin dakordësi me Projekt/Aktin.

Znj.Truma sqaron edhe njëherë orarin e zhurmave sipas planit që të mos ketë keqkuptime.

Fjalën e rimerr **Z.Deda**,cili sqaron se ndarja e zonave është e mirëmenduar duke u munduar t'i jepet rëndësi zonave turistike në sezonin e verës, por gjithmonë duke mos rënë ndesh me planin dhe nevojat e bizneseve e qytetarëve.

Z.Lakti merr fjalën dhe thotë që Pr/Vendimi është i vonuar por gjithsesi përderisa oraret janë vendosur nga qeveria,këshilli nuk mund të dalë me orare tjera sepse në të kundërt bizneset do kenë pasoja me policinë.Ai propozon që oraret t'i referohen orareve të vendosura nga Ministria duke respektuar planin normativ.

Znj.Mandija shprehet dakort por duke propozuar që Bashkia të azhornohet me oraret e reja që mund të pasojnë.
Edhe Z.Sokoli shprehet dakort. Projekt akti hidhet në votim, ku rezultojnë 31 vota Pro, 1 Kundër, 1 Abstenim.
Miratohet

5.Vijohet me pikën 5. të rendit të ditës: Pr/Vendim: *"Për një ndryshim në VKB nr.3 datë 05.01.2022"Për miratimin e buxhetit të vitit 2022 dhe progamit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2022-2024 të Bashkisë Shkodër".*

Përsëri relaton shkurtimisht Zv.Kryetari i Bashkisë **Z.Deda** sipas materialit të përgatitur nga punonjësit e administratës. .

Fjala është përsëri për **Znj.Leqejza**,e cila në emër të komisionit relaton duke iu referuar materialit të përgatitur nga komisioni duke theksuar që nuk shihet e arsyeshme që të ketë ndryshime në destinacionin e parashikuar të disa zërave buxhetor. Ajo kërkon që Pr/akti të paraqitet edhe njëherë në formatin e kërkuar, i rankuar sipas pikëve dhe përparësive që ato kanë në buxhet. Megjithatë në parim shprehen dakort si komision me Pr/vendimin.

Z.Hallunaj shprehet dakort me rialokimin e fondeve për ndërhyrje në rrugët kryesore sepse mendon që keto fonde nuk do zgjidhin probleme të tjera si ai i mbetjeve apo dicka tjetër.Ekziston mundësia e rregullim të qytetit.

Edhe **Z.Sokoli** vlereson relacionin e Komisionit por sheh si shumë të rëndësishme ndërhyrjen në rrugët e qytetit.

Z.Marku merr fjalën dhe kërkon të dijë pse Zv/Kryetari i bashkisë thotë që komisioni ka dhënë ok? Atëherë a ka pasur pasaktësi apo komisioni ka ndryshuar qëndrim?

Znj.Leqejza shprehet se komisioni nuk është dakort me miratimin e Pr/vendimit në formën që është sepse metodologjia e rankimit / pikëzimit nuk është e duhura. Le të riparaqitet dhe të argumentohet pse i është dhënë përparësi rrugëve dhe nevojave të caktuara.

Z.Spahia shprehet se të gjithë duhet ta shohin miratimin e këtij Pr/akti të zhveshur nga pikpamjet politike përsa kohë synimi i përbashkët është përmirësimi i jetës së komunitetit në Shkodër. Ai garanton se ky Pr/vendim është rezultat i diskutimeve të gjata të administratës, shqyrtimit të detajuar nga ana e ekspertëve të fushës, të cilët kanë pasur gjithmonë në vemendje nevojat dhe impaktin që kanë ndërhyrjet në fjalë në këtë qytet. Synimi mbetet që të ofrojmë maksimumin me kaq financa që kemi.

Problemi i fushës së mbetjevë nuk është lënë jashtë vëmendjes, por për të kemi një vizion dhe mendojmë një zgjidhje tjeter.

Pa dashur të replikojë **Znj.Leqejza** kërkon të dijë a ka patur paritet në ndarjen e investimeve në Njësitë Adm. dhe në qytet,duke pasur parasysh këtu edhe kërkesat për ndërhyrje të dala nga dëgjesat publike.Rithekson faktin që komisioni mban qëndrim për formën dhe jo për përmbajtjen e këtij Pr/akti.

Përsëri **Z.Spahia** sqron se sistemi i pikëzimit vlen brenda njësisë,pra brenda një rajoni/zone, ky dhe shihen prioritetet.

Ndërhyn **Znj.Leqejza** e cila thotë që kjo është edhe ajo cka ato kërkojnë rankimin dhe mënyrën e pikëzimit sa më real.

Edhe njëherë **Z.Spahia** thekson faktin se ndryshimet në prioritete e ndërhyrje janë vendosur të pa ndikuara politikisht,thjesht të nusur nga kërkesat e qytetarëve tq Shkodrës.

Fjalën e merr **Z.Celiku**, i cili mendon që ndërhyrjet janë parashikuar në mënyrë selektive.Shembull është edhe rruga "Europa" që e vërteton më së miri këtë,duke qënë imazhi i parë për qytetarët dhe turistët.Po ashtu ai shpreh shqetësimin e tij në lidhje me vendosjen e një cezmeje tek varrezat e qytetit.

Z.Nika vlerëson punën e koleges Leqejza dhe komisionit dhe ka disa pikëpyetje teknike në lidhje me rialokimin e fondeve për arsimin.Megjithatë ajo shpreson në ofrimin e më së mirës për qytetarët.

Fjalën e merr **Z.Celaj** i cili shprehet se në dëgjesat e zhvilluara , është kërkuar me domosdoshmëri ndërhyrja në rrugën e Mesit dhe se kupton që sipas sistemit të pikëzimit nuk del si prioritet. Gjithashtu ai risjell edhe shqetësimin e mungesës së ujit të pijshën në 90% të Postribës.

Z.Hasaj merr fjalën dhe si këshilltar i Nj.Adm Rrethina sjell shqetësimin e shkollave të asaj zone duke u shprehur që nuk sheh në këtë Pr/vendim asnjë parashikim për ndërhyrje. Po ashtu edhe rrugët atje janë në gjendje të mjerueshme, edhe uji dhe mbetjet vazhdojnë të mbeten problem. Ai shton se zona ka nevojë edhe për një qendër shëndetsore të re. Ai mendoj se edhe njësit administrative kanë nevojë për vëmendje.

Z.Spahia sqaron se shkolla "I.Salibrucaj" është në proces tenderimi dhe shumë shpejt do ketë ndërhyrje. Është parashikuar edhe një rrugë si prioritet. Sot po kërkohet një rialokim dhe jo ndryshim buxheti në tërësi.

Fjala për **Z.Galiqi** i cili vëren që ka një vullnet të përbashkët por thjesht nuk ka dakordësi përsa i përket metodologjisë. Ai mendon që ky projekt të rivlerësohet dhe të sillet në mbledhjen e ardhshme për miratim, që secili të jetë i bindur për saktësinë e sistemit.

Përsëri **Z.Spahia** sqaron se impakti dhe rëndësia e rrugëve në fjalë është e madhe prandaj edhe nevojitet ndërhyrje sa më e shpejtë.

Fjalën e merr **Z.Metushi**, i cili shpreh shqetësimin e tij në lidhje me shërbimin në qendra shëndetësore. Qenda Shëndetësore në Theth, Rrjoll , në Maj Kolaj etj. Ka rreth 16 qendra për të cilat akoma nuk ka një Pr/ vendim nga ana e bashkisë. Ai beson që ky është shërbimi kryesor për kominitetin.

Edhe njëherë kryetari i bashkisë **Z.Spahia** thekson se nuk ka asnjeë ndryshim në destinacionin e fondeve, thjesht rialokim duke mos mohuar asnjëherë kërkesat e tjera. Të gjitha do kenë vemendjen absolute.

Z.Lakti edhe njëherë merr fjalën dhe thotë që buxheti është parashikuar dhe menduar të bazë të kërkesave dhe nevojave që vetë qytetarët i kanë vendosur si prioritete në dëgjesat publike, prandaj ai është shumë dakort për këtë rialokim duke mos anashkaluar parashikimet tjera ,të cilat duhen realizuar.

Kalohet në mendimin e kryetarëve të grupeve. **Z.Osja** në emër të grupit Socialist shprehet kundra miratimit të pikës 5.

Z.Sokoli shprehet pro në emër të grupit të këshilltarëve të PSD-së. Projekt akti hidhet në votim, ku rezultojnë 6 vota Pro, 22 Kundër, 3 Abstenim.
Nuk Miratohet

6.Vijohet me pikën 6. të rendit të ditës: Pr/Vendim: *"Për shtesë në buxhetin e vitit 2022, e miratuar me VKB nr.3 datë 05.01.2022 dhe dhe progamit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2022-2024 të Bashkisë Shkodër".*

Përsëri N/Kryetari i Bashkisë relaton sipas materialit të përgatitur nga punonjësit e administratës.

Znj.Leqejza në emër të komisionit shprehet se pas shqyrtimit të Pr/aktit, komisioni gjykon se është korrekt dhe fton kolegët ta miratojnë atë.

Z.Spahia merr fjalën përsëri dhe shprehet se zonat rurale asnjëherë nuk kanë qënë jashtë vëmendjes.

Z.Metushi kërkon të dijë,nëse ka pasur më parë ndërhyrje në rrugën në fjalë?

Z.Deda përgjigjet se ka pasyr ndërhyrje të vogla për shkak të pamundësive financiar të bashkisë Shkodër.Rehabilitimet janë kryer vetëm në segmente të shkurtra.

Duke mos qënë më kuorumi i domosdoshëm në sallë, mbledhja nuk mund të vazhdojë. Znj.Truma e deklaron mbledhjen e mbyllur.

Procesverbali, pasqyron në mënyrë të përmbledhur diskutimet e mbledhjes së këshillit bashkiak Shkodër të datës 26.07.2022. Bashkëlidhur këtij procesverbali, materiali i mbledhjes Audio.(DVD).

Procesverbali përmban 7 faqe dhe pasi lexohet, nënshkruhet pa vërejtje nga:

Sekretar

Denis LESHA

KRYETARE

Brisela KADIJA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR